



Institucioni : Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L – 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave shpall :

KONKURS I BRENDSHËM (Avancim)

Titulli i punës: Inspektor i lartë për sigurinë hekurudhore

Nr.ref. RN00004872

Mbikëqyrës: Drejtori i Departamentit të Sigurisë

Qëllimi i vendit të punës: Të ndihmoj në mbarëvajtjen e procesit të inspektimit dhe regjistrimit të inspektimeve për sigurinë hekurudhore.

Detyrat Kryesore

- Udhëheqë dhe ndihmon në përgatitjen e procedurave të pranimit të pajisjeve hekurudhore për sa i përket
- sigurisë dhe interoperabilitetit.
- Kryej inspektime të sigurisë në lokalet e menaxhereve të infrastrukturës dhe ndërmarrjeve hekurudhore.
- Mbikëqyrë dhe inspekton transportin e mallrave të rrezikshme dhe substancave bërthamore.
- Zhvillimi, organizimi dhe implementimi i rregulloreve për menaxhimin e trajnimeve, ekzaminimin, licencimin e
- personave që transportojnë pajisje speciale për personat që operojnë në hekurudha.
- Mbikëqyrë Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë hekurudhore (SMS), pershtatjen e Direktivave të BE-së si dhe
- Rregullave Nacionale të Sigurisë.
- Krijoj procedura për procesin e pranimit e pajisjeve të hekurudhave me theks tek siguria dhe interprobaliteti.
- Ndihmon në përcaktimin e rregullave për certifikata të sigurisë.
- Të kryej punë tjera të cilat caktohen nga mbikëqyrësi.

Shkathtësitë e kërkuara

- Diplomë Universitare në fushën e komunikacionit, ekonimikut, së paku 3 vite përvojë pune, e preferueshme në sektorin publik
- Aftësi të mira komunikimi dhe këmbëngulësi
- Të ketë kredibilitet dhe aftësi të mira dhe sjellje organizative dhe shkathsi dhe një performancë në punë
- Njohuri rreth Ligjit për Hekurudhat e Kosovës
- Aftësi të pranueshme në të shkruar dhe në të folur në shqip e preferuar serbisht dhe anglisht
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, internet)

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e administratës

Konkursi është i hapur 8 ditë kalendarike nga dita e publikimit të shpalljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për këtë vend pune, për të cilin konkurrenca.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësitë e barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Shpallur më 17.05.2019 deri 24.05.2019 ora 16:00